



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

RAPORT I VITIT 2025

**PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK,
I REALIZUAR NGA MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2025, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka përmbushur detyrimin për konsultim publik të akteve, objekt i ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, për 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) projekt aktet e planifikuara në PVKP 2025.

Konkretisht janë konsultuar nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe aktiviteteve të tjera konsultative 8 projektligje dhe 4 projektvendime (ku përfshihen dhe 6 (gjashtë) projekte të cilat nuk ishin planifikuar në PVKP 2025.

1. Projektligji, “Për performancën energjetike të ndërtesave”;
2. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimit të Stokut të Ndërtesave”;
3. Projektligji, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
4. Projektvendimi, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Sektorit Minerar 2026-2040”;
5. Projektligji, “Për efikasitetin energjetike”;
6. Projektvendimi, “Për miratimin e planit kombëtar për rinovimin e ndërtesave”;
7. Projektligjin, “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj”;
8. Projektligjin, “Për përcaktimin e kërkesave për projektimin ekologjik të produkteve me ndikim në energji”;
9. Projektvendimi, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore 2026-2030 dhe planin e veprimit për sigurinë rrugore 2026-2028”;
10. Projektligji, “Për lirimin e frekuencave të Digjital Divident dy (DD2)”;
11. Projektligji, “Për disa ndryshime në ligjin e sektorit të energjisë”;
12. Projektligji, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë vitit 2025, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kishte planifikuar për konsultim publik 9 projekt akte, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe konsultimin publik”, nga të cilat 2 (dy) janë konsultuar dhe miratuar.

Format e përzgjedhura të konsultimit publik kanë rezultuar efektive duke mundur mbledhjen dhe reflektimin e reagimeve të palëve të interesit në draftin përfundimtar më qëllim krijimin e një akti të gjithë pranuar dhe që reflekton interesin e publikut. Rritja e pjesëmarrjes

së qytetarëve në procesin e vendim marrjes nëpërmjet procesit të konsultimit publik mbetet sfida për t'u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë në të ardhmen.

Krahasuar me vitin e kaluar ministria ka performuar me mirë lidhur me këtë proces, duke diversifikuar metodat e përdorura për konsultim publik dhe duke i përzgjedhur ato në varësi të kompleksitetit të akteve.

Një problematikë që vlen të theksohet është se ka shumë vizitorë në RENJKP, qytetarë dhe ekspertë, por janë të paktë ata që lënë komente në portalin e Regjistrat Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike. Megjithatë, qytetarët/ekspertët kanë pasur mundësi dhe rrugë të tjera, si psh nëpërmjet postës elektronike për të përcjellë rekomandimet e tyre.

2. Analiza e konsultimeve të kryera gjatë vitit 2025

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka miratuar 151 akte gjatë vitit 2025, nga të cilat 111 projektvendime të Këshillit të Ministrave, 2 projektligje për ratifikim/aderim marrëveshje ndërkombëtare, 8 projektligje objekt i konsultimit publik, dhe 2 akte normative me fuqinë e ligjit.

2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Janë konsultuar gjithsej 12 projekt akte, nga të cilat vetëm 2 janë miratuar.

2.1.3 Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?


Nga projekt aktet e miratuara, është konsultuar 1 (një) projektligj me raport vlerësim ndikimi VNR, sepse projektvendimi i miratuar nuk ishte objekt VNR:

- Projektligji “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”

2.1.4 Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

- Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 812/2025 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projekt akteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026”, për vitin 2026 janë parashikuar të miratohen 27 akte, ku 17 prej tyre përjashtohen nga detyrimi për t’iu nënshtruar procesit të konsultimit publik, pasi konsiderohen si akte administrative individuale dhe akte administrative me karakter normativ.
- Nga 18 aktet e parashikuara në PKIE, për 12 prej tyre aplikohen kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.
- Nga 13 aktet e parashikuara në dokumentet strategjike kombëtare dhe sektoriale, për 10 prej tyre aplikohen kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Grafik 1: Përdorimi i kriterëve të përjashtimit nga konsultimi publik



2.1.4 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Aktet e miratuara, objekt i konsultimit publik gjatë vitit 2025, janë 2 (dy) projekt akte, konkretisht:

1. Projektligji “Për performancën Energjetike të ndërtesave”;
2. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimin të Stokut të Ndërtesave”.

2.1.6 A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar me performancën institucionale të vitit të kaluar, MIE, për periudhën e raportimit ka realizuar një proces efektiv konsultimi publik për projektligjet e miratuara.

2.2 Metodatat e konsultimit

Metodat e përdorura për konsultimin publik, gjatë kësaj periudhe, ishin 3 (tre):

1. Konsultimi në faqen zyrtare online të konsultimit publik, RENJKP;
2. Përcjellja e komenteve në rrugë postare dhe nëpërmjet postës elektronike të koordinatorit për konsultimin publik;
3. Tryeza konsultimi të zhvilluara në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit, të evidentuara.

2.2.1 Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik, për projektligjin “Për performancën Energjetike të ndërtesave”, ishin:

1. Publikimit të projekt aktit në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike;
2. Publikimit të projekt aktit në ëbsite zyrtare të paketës shoqëruese;
3. Ndërmjet postës elektronike të koordinatores për njoftim dhe konsultim publik.

Metodat e përdorura për konsultimin publik, për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimit të Stokut të Ndërtesave”, ishin:

1. Publikimi i projekt aktit në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike;
2. Publikimi në ëbsite zyrtar, të paketës shoqëruese;
3. Ndërmjet postës elektronike të koordinatores për njoftim dhe konsultim publik.

2.2.3 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte nëpërmjet emailit të koordinatorit për konsultimin dhe njoftimin publik si dhe regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike. Përmes publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka pasur komente.

2.2.4 A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Po, për projekt aktet e konsultuara dhe miratuara, nuk janë organizuar takime në kuadër të fazës së konsultimeve paraprake.

2.3 Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për të gjitha aktet e miratuara gjatë të vitit 2025 u realizua për të paktën 20 ditë pune, në përputhje me ligjin nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për sa i përket fazave paraprake dhe më pas publikimit në RENJK, është 9 (nëntë) muaj. Kjo përlllogaritje është bërë duke patur në vëmendje kohën (numrin e muajve) gjatë të cilës ka filluar puna për identifikimin e grupeve të interesit, hartimin e draftit, publikimin e tij në RENJK, marrjen dhe vlerësimin e komenteve dhe përgatitjen e një drafti final për projekt aktin.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në lidhje me kohëzgjatjen e konsultimeve, situata është përmirësuar në krahasim me vitet e kaluara.

2.4 Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Për projektligjin “Për performancën Energjetike të ndërtesave”, ka pasur një numër të konsiderueshëm të aktorëve të jashtëm, kryesisht ekspertë të fushës së ndërtimit, inxhinierike dhe ekspertë mjedisi, si: Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë; Unioni i Inxhinierëve Shqiptar; Co-PLAN, Institute for Habitat Development dhe grupe të tjera interesi.

Për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimin të Stokut të Ndërtesave”, ndër aktorët e interesuar ishte Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Për konsultimin e projekt akteve gjatë vitit 2025, pjesëmarrësit ishin:

- Ekspertë në fushën e ndërtimit, inxhinierisë, energjisë, mjedisit, etj;
- përfaqësues nga institucione publike të pavarura apo institucione të varësisë,
- përfaqësues nga aktorët e interesuar.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Gjatë procesit të konsultimit publik kanë dhënë komente kryesisht Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë; Unioni i Inxhinierëve Shqiptar; Co-PLAN, Institute for Habitat Development dhe grupe të tjera interesi.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?


Në lidhje me aktet të cilat janë konsultuar gjatë vitit 2025, në total janë përfshirë disa ekspertë dhe shoqata të cilat kanë dhënë kontributin e tyre dhe konkretisht:

Struktura e përfaqësuesve kontribuues në konsultimet publike, ishte:

- Për projektligjin “Për performancën Energjetike të ndërtesave”, përfaqësuesit kontribuues ishin nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë; Unioni i Inxhinierëve Shqiptar; Co-PLAN, Institute for Habitat Development;
- Për projekt vendimin “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimin të Stokut të Ndërtesave”, përfaqësuesit kontribuues ishin nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata për vitin 2025 paraqitet e njëjtë si vitin e kaluar. Procesi i konsultimi ka qenë pro aktiv dhe gjithëpërfshirës, duke zhvilluar konsultime të fazuara dhe mundësuar kështu pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesit. Një tjetër tregues rezulton nga monitorimi i portalit të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike pasi vërehet një rritje e numrit të qytetarëve që ndjekin projekt aktet e publikuara në të dhe dërgimi i komenteve përmes kësaj platforme. Megjithatë, nisur nga verifikimi i realizuar, numri total të vizitorëve për projekt aktet gjatë vitit 2025 është 591 ekspertë dhe qytetarë.



2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Për projekt aktet e konsultuara gjatë vitit 2025, numri total i komenteve të përcjella ka qenë 42.

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

- 19, u pranuan plotësisht;
- 23, u refuzuan.

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Konstatohet se tendenca është më njëjtë me vitin e kaluar. Konstatohet një ndryshim i trendit të mbledhjes së komenteve, ku metodat elektronike të konsultimit nëpërmjet email-it apo RENJKP gjenerojnë numër të konsiderueshëm komentesh.

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Raporti i VNR nuk është përditësuar në përfundim të procesit të konsultimit pasi reagimet e mbledhura nuk ndryshojnë implikimet e politikës së krijuar.

2.6 Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1 Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Për vitin 2025, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i ka publikuar të dy raportet e konsultimit për projektet e konsultuara dhe të miratuara.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Janë publikuar të gjitha raportet e konsultimit për aktet e konsultuara dhe miratuara.

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin

publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Duke marrë në konsideratë metodologjinë e pikëzimit “Projektligjet publikohen në sistemin e informacionit të qeverisë, është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit; janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre, në draftin e ri pasqyrohet dhe reflektohet reagimi të palëve të interesuara”, konsultimi publik për projektligjet, vlerësohet me 8 pikë.

3. **Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Për sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik mund të përmendim gjithë përfshirjen e publikut, ndërmjet një angazhimi më të madh në këtë proces. Me qëllim përmirësimit e procesit të konsultimit publik, sugjerohet organizimi i konsultimeve përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik.